



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 1782/4 Prot.

Tiranë, më 27.01 2015

VENDIM

Nr. 10, datë 27.01/2015

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e Informimit”, nenit 31/1/a të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale,

V Ë R E N:

Ankuesi, shtetasi _____ ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit ankesën nr. 1792/2 Prot., datë 26.12.2014, me objekt “*Ankim ndaj refuzimit për dhënie të informacionit dhe kopje të dokumenteve zyrtare*”, kundër Autoritetit Publik/Ministritsë së Kulturës. Nga provat bashkëngjitur ankesës rezulton se, ankuesi në cilësinë e kërkuesit ka paraqitur pranë Autoritetit Publik/ Ministritsë së Kulturës, kërkesën nr.5925 Prot., datë 18.12.2014, me objekt, “Kërkesë për vënie në dispozicion të dokumentacionit”, nëpërmjet së cilës ka kërkuar të informohet lidhur me, 1) Kopje të vlerësimit të platformës së tij; 2) Kopje të platformës së fituesit; 3) Kopje të vlerësimeve të platformës së fituesit.

Komisioneri vëren se ankesa është depozituar përpara përfundimit të afatit kohor të parashikuar në pikën 1 të nenit 15 të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, sipas të cilit autoriteti publik duhet të trajtojë kërkesën dhe brenda 10 ditë pune të japë informacionin/dokumentacionin kërkuesit me një nga mënyrat e parashikuara në ligj. Ankuesi në datë 7.01.2015 ka paraqitur në vijim të ankesës së datës 26. 12.2014, kërkesë për tu ndjekur procesi i shqyrtimit të ankesës për shkak të mos marrjes së përgjigjes nga autoriteti publik/Ministria e Kulturës. Nga shqyrtimi i ankesës bashkë me kërkesën vijuese të saj, konstatohet se ankuesi/Z.1 _____ legjitimohet të paraqesë këtë ankesë, në përputhje me pikën 2 të nenit 24 të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”.

Nga dokumentacioni i depozituar rezulton se, Autoriteti Publik/Ministria e Kulturës, nuk i është përgjigjur kërkuesit lidhur me kërkesën e tij për informim.

Në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, Komisioneri bazuar në pikën 3 të nenit 24 të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, ka kërkuar nga Ministria e Kulturës, që deri në datë 15.01.2015 të depozitojë parashtrimet me shkrim mbi ankesën e paraqitur nga Z. . Pas kalimit të afatit të caktuar, nuk rezulton të jenë dërguar parashtrimet e kërkuara.

Autoriteti publik do të duhej të trajtonte kërkesën në përputhje me nenin 7 të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit” për të vlerësuar nëse informacioni i kërkuar i përket informacionit që bëhet publik pa kërkesë si dhe me nenin 17 të ligjit të lartpërmendur për të vlerësuar nëse informacioni mund të refuzohet në dhënien e tij tërësisht apo pjesërisht për shkak të kufizimeve që përcakton kjo dispozitë dhe më pas të jepte përgjigjen e duhur ligjore. Rezulton se, Ministria e Kulturës ka vepruar në kundërshtim me pikën 1 të nenit 15 të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”. Në përputhje me pikën 4 të nenit 15 të ligjit të lartpërmendur mostrajtimi i kërkesës për informim brenda afateve të përcaktuara në ligj konsiderohet refuzim. Në përputhje me shkronjën “a” të pikës 2 të nenit 18 të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, “Refuzimi i dhënies së informacionit në kundërshtim me parashikimet e këtij ligji dënohet me 150.000 deri në 300.000 lekë”.

Në përfundim, në lidhje me ankesën e Z. kundër Autoriteti Publik/Ministria e Kulturës, Komisioneri vlerëson se, ankesa është e bazuar në ligj dhe si e tillë ajo duhet pranuar.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në shkronjat b) dhe ç) të pikës 5 të nenit 24 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”,

V E N D O S A:

1. Pranimin e ankesës nr. 1792/2 Prot., datë 26.12.2014, të Z. .
2. Urdhërimin e Autoritetit Publik/Ministrinë e Kulturës për të dhënë informacionin/dokumentacionin e kërkuar ankuesit brenda datës 02.01.2015.

Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative kompetente, në përputhje me nenin 25 të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”.

Ky vendim u dha sot në datë 27.01.2015.

